



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 5/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Spiro Kuro	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.01.2015 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikim i kriterëve për kualifikim të vendosura në dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin monetar*” me objekt: “*Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet “QSU – Nënë Tereza” Tiranë*”, me fond limit 1.106.416.176,7050 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2015, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë”.

Ankimues: “Devis” sh.p.k.
Rruga “Sami Frashëri”, Pall. 22/1, Tiranë

Palë e ankimuar: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë,

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes z. Gentian Këri, znj. Juliana Hoxha, z. Spiro Kuro, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.12.2014, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin monetar*” me objekt: “*Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet “QSU-Nënë Tereza” Tiranë*”, me fond limit 1.106.416.176,7050 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 15.12.2014, operatori ekonomik “Devis” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...]

1. Në shtojcën 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, shkronja a) ju keni kërkuar: a) Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku vlera e tre viteve të marra së bashku të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit në shumën prej 442 566 470.682 (katërqind e dyzetë e dy million e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë 682) lekë. Ky kriter vjen në kundërshtim me nenin 2 dhe 46 të ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 si dhe me VKM nr. 1, datë 10/01/2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, Kreu II, pika 3

“Informacione specifike”, pika b, Kontratat e mallrave dhe pika c, Kontrata e shërbimeve, ku përcaktohet se: [...]

2. Në Shtojcën 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, përsa i përket aftësisë teknike e profesionale a) ju keni kërkuar: a) shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra së bashku, në një vlerë jo më të madhe se 40% të fondit limit në shumën prej 442.566.470,682 (katërqind e dyzetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë 682) lekë. Për kapacitetet ekonomik dhe financiar:

Kopje të deklaratave dhe xhiros vjetore e shoqëruar me vërtetim nga dega tatim taksave për tre vitet e fundit 2011, 2012, 2013 në masën 40% të fondit limit mendojmë që zbatimi i këtij kriteri është i lartë afër kufirit max dhe në një vlerë relativisht shumë të lartë dhe nuk i shërben konkurrencës së ndershme, sepse një firmë mund të ketë bilanc pozitiv dhe në një vlerë më të vogël se 40% e fondit limit dhe një eksperiencë të pasur në këtë fushë dhe ky kriter do përbente një diskriminim për të mos marrë pjesë në konkurim ose për të sjellë skualifikimin e tij.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke sugjeruar që të bëhet: Vërtetim nga Dega e tatim taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit vlera mesatare e tyre të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit.

- 2) Në shtojcën 7, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, Licencat profesionale shkronja e) ju keni kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për vitet 2012, 2013 dhe Janar – Nëntor 2014 e vërtetuar kjo me vërtetim nga dega e tatim taksave për numrin e punëtorëve të siguruar e shoqëruar dhe me listë pagesat (formularët E – sig025a).

Duke qenë se shërbimi i luanterisë nuk kërkon licenca specifike ose kualifikime të veçanta, numri prej 60 punonjësish është i tepruar për të vetmen arsye se nuk na duket i justifikuar dhe i mbështetur në arsyetim, sepse një kompani mund të ketë automatizim më të lartë të pajisjeve teknike të shërbimit që nuk kërkojnë një numër të lartë punonjësish për të kryer këtë shërbim.

Për këtë arsye: I kërkojmë autoritetit kontraktor që numri i punonjësve për vitin 2012, 2013 dhe janar – nëntor 2014 të jetë jo më shumë se 30 punonjës.

- 3) Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke sugjeruar që të bëhet: Realizim kontrata të ngjashme deri në masën 20% e fondit limit.

- 4) Në Shtojcën Makineritë dhe pajisjet e domosdoshme për kryerjen e shërbimit janë kërkuar përkatësisht:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Lavatriçe Larëse Profesionale	Copë	4
2	Barriera Larëse Profesionale	Copë	2
3	Makinë Tharëse Profesionale	Copë	4
4	Hekur Rul Profesionale	Copë	2
5	Makineri Paketuese për Materialin e Butë	Copë	1
6	Karoca Shërbimi	Copë	30
7	Kosha për Mbajtje Teshash	Copë	20
8	Karrela Transportues Teshash	Copë	60
9	Peshore Elektronike mbi 100 kg	Copë	3

Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të na japi një argumentim pse ka vendosur nr. e këtyre pajisjeve, sepse ne mendojmë që ka disa mospërputhje me nr. dhe funksionin e këtyre pajisjeve konkretisht: pasi nuk është vendosur se sa kg duhet të jenë makineritë larëse dhe tharëse dhe se çfarë ndryshimi ka karroca nga kosha dhe karrela dhe çfarë funksioni kryejnë karrocet e shërbimit.

Në këto kushte kërkojmë nga ana juaj modifikimin e kriterëve të sipërpërmendura të cilat bien ndesh me parimet e përgjithshme të ligjit të prokurimit publik, si konkurrenca e lirë, parimi i diskriminimit, trajtimi i barabartë i ofertuesve, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” si dhe VKM nr. 1, ku cilësohet se kërkesat duhet të jenë të lidhura ngushtë dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe jo diskriminuese.

II.3. Në datën 19.12.2014 me shkresën nr. 5434/1 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik, duke e pranuar pjesërisht ankesën dhe duke bërë modifikimin e disa prej kriterëve të ankimuar.

II.4. Në datën 26.12.2014 operatori ekonomik “Devis” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, në të cilën pretendon modifikimin e disa kriterëve për kualifikim dhe konkretisht kriterin për xhiron; kriterin për shërbimet e mëparshme të ngjashme; kriterin për numrin e punonjësve.

II.5. Në datën 05.01.2015, nëpërmjet shkresës me nr. 5743/1 prot., datë 31.12.2014 me objekt “Kthim përgjigje Vendimit nr. 1967/1 datë 29.12.2014”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k., për *xhiron*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në datën 11.12.2014 në sistemin e prokurimeve elektronike, Shtojca 7, “*Kapaciteti ekonomik e financiar*”, gërma “a”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri “*Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku vlera e tre viteve të marra sëbashku të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit në shumën prej 442 566 470.682 (katërqind e dyzetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë 682) lekë*”.

II.1.2. Në dokumentat e tenderit, në dokumentin “*Shtojcë në DST*”, të publikuar në datën 19.12.2014 në sistemin e prokurimeve elektronike, Shtojca 7, “*Kapaciteti ekonomik e financiar*”, gërma “a”, nga autoriteti kontraktor është modifikuar kriteri për *xhiron* duke u përcaktuar “*Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku vlera e tre viteve të marra sëbashku të jetë jo më e vogël se 35 % e fondit limit në shumën prej 387 245 661.84675 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një pikë 84675) lekë*”.

III.1.3. Në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, në Kreun III, pika 3, gërma “c”, përcaktohet se: “[...] *Për kapacitetet financiare dhe ekonomike: a. Kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, dhe/ose; b. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore dhe/ose; c. Një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka [...]*”.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.....Nuk lejohet përcaktimi kufijve monetarë skualifikues, te cilet tejkalojnë vlerën limit të kontratës që prokurohet”.

III.1.4. Në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, në Kreun VII, pika 3, gërma “c”, përcaktohet se: “*Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të përlllogarisë fondin total dhe të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me to*”.

III.1.5. Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik sqaron se “*kjo kontratë është komplekse pasi në vetvete ky shërbim përfshin ofrimin nga procesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë të shtratit të pacientit, ku sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse, dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese transportuese, të shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit si dhe përveç kësaj, sipërmarrësi duhet të sigurojë zëvendësimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar (sipas kohës së tyre të amortizimit)*”.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e QSU Nënë Tereza Tiranë, nga natyra e tij është një shërbim i rëndësishëm, specifik, i cili përbëhet nga një tërësi elementësh të lidhur ngushtë ndërmjet tyre e të gërshetuar mirë, të cilët plotësojnë njëri – tjetrin. Vlen të theksohet gjithashtu, se kjo kontratë është shumëvjeçare me një periudhë zgjatjeje prej 4 vjetësh dhe hartimi i kriterëve për

kualifikim, referuar edhe bazës ligjore të sipërpërmendur, është përcaktuar në përputhje me këtë fond, por gjithnjë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në kufijtë monetarë të cilët nuk tejkalojnë vlerën limit të kontratës objekt prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Nisur nga edhe nga argumentimi i autoritetit kontraktor, KPP vlerëson se kjo kërkesë është në përpjesëtim me objektin e prokurimit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Përsa i përket kriterit të xhiros të hartuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ka disa pasaktësira, referuar dokumentave të tenderit, shtojcës së dokumentave të tenderit dhe kthimit të përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k. dhe konkretisht:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në datën 11.12.2014 në sistemin e prokurimeve elektronike, Shtojca 7, “*Kapaciteti ekonomik e financiar*”, gërma “a”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri “*Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku vlera e tre viteve të marra sëbashku të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit në shumën prej 442 566 470.682 (katërqind e dyzetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë 682) lekë*”.

II.2.2. Në informacionin e sjellë nga autoriteti kontraktor pranë KPP rezulton se operatorit ekonomik i është kthyer përgjigje duke ja pranuar pjesërisht ankesën dhe duke e riformuluar kriterin si më poshtë: “*Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit vlera mesatare e tyre të jetë jo më e vogël se 35 % e fondit limit në shumën prej 387 245 661.84675 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një pikë 84675) lekë*”.

III.2.3. Në shtojcën e publikuar në datën 19.12.2014 është shprehur se kriteri ishte:

“*Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit ku vlera mesatare e tyre te jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit ne shumen prej 442 566 470.682 (katerqind e dyzete e dy milion e peseqind e gjashtedhjete e gjashte mije e katerqind e shtatedhjet pike 682) lekë*”

dhe bëhet

“Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku vlera e tre viteve të marra sëbashku të jetë jo më e vogël se 35 % e fondit limit në shumën prej 387 245 661.84675 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një pikë 84675) lekë.

Në lidhje me mospërputhjen për kriterin *xhiro mesatare për 3 vitet e fundit dhe xhiro për 3 vitet e fundit të marra së bashku*, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson t’i qëndrojë përcaktimit të bërë nga autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar në datën 19.12.2014 në sistemin elektronik të prokurimeve (*xhiro vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit ku vlera e tre viteve të marra sëbashku të jetë jo më e vogël se 35 % e fondit limit*), e cila është bërë publike dhe i është njoftuar të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar përfshirë këtu edhe vetë ankimuesin. Ky përcaktim shkon edhe në interes të pretendimit të ankimuesit i cili shprehet se *kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor është në një vlerë relativisht shumë të lartë dhe nuk i shërben konkurrencës së ndershme*, pasi nga përlllogaritjet në vlerë matematikore, vlera e tre viteve të marra së bashku është në një vlerë më të favorshme për përmbushjen e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor se sa vlera mesatare e tre viteve.

III.2.4. Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kriterit *“..... xhiro vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit...”* ka një pasaktësi, pasi ka përdorur edhe fjalën *vjetore*, e cila nënkupton xhiron e një viti financiar, edhe togfjalëshin *“të 3 viteve të fundit”*, i cili e hedh poshtë kuptimin e fjalës *vjetore*. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e këtij kriteri duhet të jetë i saktë, pasi termi *xhiro vjetore* është një term përgjithësues që nënkupton xhiron e realizuar në një vit financiar nga një operator ekonomik dhe fjala *vjetor* bie poshtë në momentin që në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor e vlerëson të nevojshme se kjo xhiro duhet për më shumë se një vit.

Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor duhet të bëjë saktësimin e duhur për të mos lënë vend për paqartësi, në përputhje me konstatimin e mësipërm.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k., për *shërbimet e ngjashme*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në datën 11.12.2014 në sistemin e prokurimeve elektronike, Shtojca 7, *“Kapaciteti teknik”*, gërma “a”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri *“Shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra sëbashku, në një vlerë jo më të madhe se 40 % të fondit limit në shumën prej 442 566 470.682 (katërqind e dyzetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë 682) lekë.*

- *Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/tyre nga autoriteti kontraktor.*
- *Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse dhe/ose faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasisë, emërtimet, vlerat)”*.

II.3.2. Në dokumentat e tenderit, në dokumentin “*Shtojcë në DST*”, të publikuar në datën 19.12.2014 në sistemin e prokurimeve elektronike, Shtojca 7, “*Kapaciteti teknik*”, gërma “a”, nga autoriteti kontraktor është modifikuar kriteri për kontratat e ngjashme duke u përcaktuar “*Shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra sebashku, në një vlerë jo më të madhe se 40 % të fondit limit në shumën prej 442 566 470.682 (katërqind e dyzetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë pikë 682) lekë. - Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/tyre nga autoriteti kontraktor.* - *Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse dhe/ose faturat tatimore të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat)*”.

III.3.3. Në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, në Kreun III, pika 3, gërma “c”, përcaktohet se: “[...] *Në lidhje me përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor mund të kërkojë dëshmi të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit financiare. “Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.....Nuk lejohet përcaktimi kufijve monetarë skualifikues, te cilet tejkalojnë vlerën limit të kontratës që prokurohet”.

III.3.4. Në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, në Kreun VII, pika 3, gërma “c”, përcaktohet se: “*Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të përllogarisë fondin total dhe të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me to*”.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik nisur nga sa më lart, vlerëson se shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e QSU Nënë Tereza Tiranë, nga natyra e tij është një shërbim i rëndësishëm, specifik, i cili përbëhet nga një tërësi elementësh të lidhur ngushtë ndërmjet tyre e të gërshetuar mirë të cilët plotësojnë njëri – tjetrin. Gjithashtu vlen të theksohet se kjo kontratë është shumëvjeçare me një periudhë zgjatjeje prej 4 vjetësh dhe hartimi i kriterëve për kualifikim, referuar edhe bazës ligjore të sipërpërmendur, është përcaktuar në përputhje me këtë fond por gjithnjë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në kufijtë monetarë të cilët nuk tejkalojnë vlerën limit të kontratës objekt prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

III.3.6. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti

kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më lart, referuar edhe argumentimit të autoritetit kontraktor, KPP vlerëson se kjo kërkesë është në përpjesëtim me objektin e prokurimit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Devis” sh.p.k., për *numrin e punonjësve*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në datën 11.12.2014 në sistemin e prokurimeve elektronike, Shtojca 7, “*Kapaciteti teknik*”, gërma “e”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për secilin nga vitet 2012, 2013 dhe Janar - Nëntor 2014 e vërtetuar kjo përmes:*

- *Vërtetim nga dega e tatim taksave për numrin e punonjësve të siguruar të shoqëruar dhe me listëpagesat (formularët E-sig 025 a)*”.

III.4.2. Në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, në Kreun III, pika 3, gërma “c”, në lidhje me punonjësit përcaktohet se: “[...] *Për kapacitetet teknike dhe profesionale:*

- *Kualifikimet, arsimore dhe profesionale, të stafit përgjegjës për drejtimin e punëve;*
- *Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik dhe për numrin e stafit drejtues deri në tri vitet e fundit...*”

III.4.3. Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 46 përcakton se operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.4. Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik sqaron se në hartimin dhe përcaktimin e këtij kriteri është mbështetur edhe në shtojcën 8 “*Specifikimet teknike të Menaxhimit të Procesit të Lavanderisë*” si dhe në shtojcën 10 “*Termet e Referencës*” të dokumentave të tenderit.

III.4.5. Autoriteti kontraktor në informacionin e depozituar pranë KPP-së sqaron dhe argumenton se: “*në lidhje me këtë kontratë komplekse është kërkuar numri i fuqisë punëtore minimale të domosdoshme për kryerjen e shërbimit, pasi nuk është specifikuar se çfarë karakteristikash profesionale duhet të zotërojnë punëtorët, pasi qëllimi i autoritetit kontraktor ka qenë për të patur garanci për kapacitetet në fuqi punëtore për përballimin dhe realizimin e këtij shërbimi. Objekti i procedurës së prokurimit përbëhet nga larja, dizifektimi, tharja, hekurosja, paketimi, transportimi si dhe shërndarja deri në pavion e bazës së materialit të butë si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrimi i shtratit të pacientit, pra fuqia punëtore nuk do të kryejë vetëm proceset e larjes por edhe ofrimin e shërbimit të hotelerisë në pavionet e QSUT-së*”.

Autoriteti kontraktor informon gjithashtu, se aktualisht janë rreth 52 ambiente në të gjithë pavionet të cilat janë përdorur si depo të materialit të butë nga sipërmarrësi që po ushtron aktualisht shërbimin e lavanderisë në QSUT dhe secila prej depove të materialit të butë ka një përgjegjës material (52 përgjegjës materiale) i cili përveç furnizimit dhe mbajtjes së inventarit të materialit të butë bën edhe ndërrimin e materialit të butë të shtratit të pacientit.

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik nisur nga sa më lart, vlerëson se shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e QSU Nënë Tereza Tiranë, nga natyra e tij është një shërbim i rëndësishëm, specifik, i cili përbëhet nga një tërësi elementësh të lidhur ngushtë ndërmjet tyre e të gërshetuar mirë të cilët plotësojnë njëri – tjetrin.

Gjithashtu vlen të theksohet se kjo kontratë është shumëvjeçare me një periudhë zgjatjeje prej 4 vjetësh dhe hartimi i kriterëve për kualifikim, referuar edhe bazës ligjore të sipërpërmendur, është përcaktuar në përputhje me këtë fond por gjithnjë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në kufijtë monetarë të cilët nuk tejkalojnë vlerën limit të kontratës objekt prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

III.4.7. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është autoriteti kontraktor ai që në përpjesëtim me objektin e prokurimit dhe me nevojat e tij, bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik përcakton dhe vendos disa kriteret kualifikuese me qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Bazuar në sa më sipër është autoriteti kontraktor ai që ka të drejtë të vlerësojë, argumentojë dhe përcaktojë kriteret të veçanta për kualifikim për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe standardet e kërkuara.

Rrjedhimisht, nisur edhe nga argumentimi i autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kjo kërkesë është në përpjesëtim dhe e lidhur me objektin e kontratës që prokurohet, ndaj pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Devis” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin monetar*” me objekt: “*Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet “QSU-Nënë Tereza” Tiranë*”, me fond limit 1.106.416.176,7050 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2015, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1967 Protokolli,
Datë 26.12.2014

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Spiro Kuro

Kryetar
Gentian Këri